



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punjtjenj/Predato Received/Delivered	02. 12 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Hi Prot Bi Prot Prot No	Shitje e Protog Appendix	Sasia Kolicitana Quantity
KPMSSHCK	5787/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.877/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional-procesmbajtës, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.n. 877/2021 të datës 21.10.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Ukshin Hoti", Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datën 02.12.2021, mori këtë :

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.877/2021 e datës 21.10.2021, të parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit 4019/2 i datës 14.10.2021 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 21.10.2021 në formë elektronike ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokollit 4019/2 të datës 14.10.2021 të Njesisë së Burimeve Njerëzor në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (më tej KPMSSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 05.11.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërsa më datë 09.11.2021 KPMSSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje



meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5114/2021 të datës 21.10.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë-Plotësim i Ankesë i datës 22.10.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 05.11.2021; E-mail nga V.Ç për Ankesa KPMSHCK i datës 22.10.2021; E-mail nga V.Ç. për Ankesa KPMSHCK i datës 21.10.2021; E-mail nga V.Ç. për Ankesa KPMSCHK i datës 22.10.2021; E-mail nga për Ankesa KPMSCHK i datës 21.10.2021; E-mail nga për Ankesa KPMSCHK i datës 21.10.2021; Ligji Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike; Vendim me nr. 07/12 i datës 09.07.2020; Vendim me nr. 2492 i datës 16.06.2021; Ankesë me nr. 4019 i datës 12.10.2021; Vendim me nr. 4019/2 i datës 14.10.2021; Përgjigje në ankesë e datës 09.11.2021; Akt Emërim i datës 17.12.2018; Shpallje e Brendshme e Konkursit e datës 17.10.2018; Konkurs Lëvizje brenda kategorisë i datës 07.06.2021; Konkurs Ngritje (avancim) në detyrë i datës 06.09.2021; Akt Emërim i datës 01.10.2014; Rregullore (QRK) nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; E-mail i datës 24.11.2021; Lista e Aplikantëve SIMBNJ- Sistemi për menaxhimin e burimeve njerëzore; Aplikacioni i A.J. i datës 29.09.2021; Diplomë me nr. 818 i datës 15.03.2004; Diplomë me nr. 87 i datës 06.10.2011; Certifikatë e datës 21.03.2006; Certifikatë e muajit Maj 2010; Akt Emërimi i datës 01.05.2012; Certifikatë e datës 16.04.2021; Certifikatë vitit 2006; Certifikatë e datës 29.06.2013; Certifikatë e notave e datës 16.04.2009; Certifikatë e datës 29.05.2013; Vërtetim i datës 23.09.2021; Vërtetim për periudhën e punës i datës 28.04.2021; Dëshmi për masë disiplinore i datës 30.09.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesionale i datës 18.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2019 i datës 23.12.2019; Aplikacioni i V.P. i datës 21.09.2021; Diplomë me nr. 5059 i datës 26.03.2015; Diplomë me nr. 2041 i datës 01.11.2019; Certifikatë e datës 14.11.2019; Certifikatë me nr.03/2 i datës 06.04.2021; Certifikatë nga Demos për ; Certifikatë nga ShKÇAK për V.P. e muajit Shtator 2015; Vërtetim i muajit Korrik 2020; Vërtetim i datës 27.07.2021; Rekomandim i muajit Korrik 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 30.11.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 05.02.2020; Vërtetim i datës 27.07.2021; Lista e Aplikantëve SIMBNJ- Sistemi për menaxhimin e burimeve njerëzore; E-mail i datës 25.11.2021; Aplikacioni i i datës 21.09.2021; Vërtetim i datës 09.06.2021; Certifikatë e datës 03.06.2019; Certifikatë e datës 30.06.2011; Akt Emërim i datës 01.10.2014; Vendim me nr. 3660 i datës 04.09.2018; Akt Emërim i datës 17.12.2018; Vendim me nr. 2402 i datës 16.06.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 24.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2019; Vërtetim i datës 09.06.2021; Diplomë me nr. 4611 i datës 05.09.2014; Certifikatë e datës 28.06.2021; Certifikatë e datës 07.06.2021; Vendim me nr. 3967 i datës 07.10.2021;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se organi i punësimit Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 06.09.2021 ka shpallur konkursin me Nr.Ref. RN00007553, Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa", e në të cilën pozitë ka aplikuar edhe ankuesi.

Me datë 07.10.2021, Njësia e Burimeve Njerëzore përmes Vendimit me numër protokolli 3967, ka njoftuar ankuesin se nuk plotëson kriteret e përcaktuara me Konkursin Nr.Ref. RN00007553, me arsyetimin se sipas konkursit tek kushtet e përgjithshme formale është kërkuar Diplomë e

studimeve universitare të Fakultetit Ekonomik me të paktën 240 kredi/ECT apo ekuivalente me te, ndërsa ankuesi në bazë të dokumentacionit të aplikimit ka diplomë universitare Fakulteti Ekonomik, Bachelor për Banka, Financa dhe Kontabilitet me gjithsej 180 ECTS/kredi.

Ankuesi kundër Vendimit me numër protokoli 3967 të datës 07.10.2021, parashtroi ankesë me datë 12.10.2021 pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore, e cila me Vendimin me numër protokoli 4019/2 të datës 14.10.2021, refuzon ankesën e ankuesit si të pabazuar, mbi fakte të njëjta sikurse në Vendimin me numër protokoli 3967 të datë 07.10.2021.

Kundër Vendimit me numër 4019/2 të datës 14.10.2021 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MBPZH, ankuesi brenda afatit ligjor parashtroi ankesë në KPMSHCK-ë, me pretendimet se nuk ka asnjë bazë ligjore për refuzimin e ankesës së tij të datës 12.10.2021, duke shtuar me tej se vendimi i atakuar me ankesë është në kundërshtim me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.07/12 të datës 09.07.2020.

Organi i punësimit me rastin e shpalljes së konkursit, ka përcaktuar kushtet e përgjithshme formale, si në vijim

- *Diplomë të studimeve universitare Fakulteti Ekonomik me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Së paku pesë (5) vite përvojë punë profesionale*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesi me rastin e aplikimit dhe si rrjedhojë ka konstatuar se ankuesi sipas Diplomës me Nr. 4611 të datës 05.09.2014 ka përfunduar studimet me 16 korrik 2014, duke marrë titullin Bachelor për Banka, Financa dhe Kontabilitet me gjithsej 180 ECTS/kredi, pra ankuesi nuk ka plotësuar kushtin e arsimimit ashtu siç është kërkuar me konkursin nr.ref.RN0007553, e mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se organi i punësimit gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore të MBPZH ka zbatuar drejtë dispozitat materiale lidhur me nxjerrjen e Vendimit me numër protokoli 4019/2 të datës 14.10.2021 dhe Vendimit me numër protokoli 3967 i datës 07.10.2021 dhe kështu ka vepruar në pajtim me nenin 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 45 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës me të cilin shprehimisht thuhet se: *"1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për avancim dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet.."*

Andaj, duke u nisur nga konstatimi se organi i punësimit ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore përkatëse, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e ankesave konstaton se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Bazuar në rrethanat si me lartë, si dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për



Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.877/2021

Clirim Zeka

Zeka

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi
Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivit të KPMSHCK-së

